

MAQEDONIA

Kushtetuta dhe Ligji i vitit 2007 për statusin ligjor të kishave, bashkësive dhe grupeve fetare e mundësojnë lirinë e besimit fetar, ndërsa ligjet dhe politikat tjera kanë kontribuar në praktikimin e lirë të besimit fetar, marrë në përgjithësi.

Qeveria, në përgjithësi, e ka respektuar lirinë fetare në praktikë. Megjithatë, mungesa e zbatimit efektiv të pjesës së regjistrimit nga ligji i vitit 2007 për statusin ligjor, , e ka vështirësuar dukshëm mundësinë e regjistruarëve të ri për marrjen e statusit ligjor.

Ka pasur disa raporte për keqpërdorime shoqërore ose diskriminim të bazuar në përkatësinë, besimin fetar ose praktikimin e fesë.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara bisedon me Qeverinë për liritë fetare, si pjesë e politikës së përgjithshme për promovimin e të drejtave të njeriut. Gjatë periudhës së raportimit, zyrtarët e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara e kanë mbështetur zbatimin efektiv dhe të drejtë të dispozitave regjistruese, sipas ligjit të vitit 2007 për statusin ligjor.

Pjesa I. Demografia fetare

Shteti ka sipërfaqe prej 25,332 km² dhe 2.1 milionë banorë. Dy grupet kryesore fetare në vend janë krishterët ortodoks dhe islami. Përafërsisht 65 për qind e popullatës janë ortodoksë maqedonas dhe 32 për qind janë myslimanë. Grupet tjera i përfshijnë katolikët, anëtarët e besimeve të ndryshme protestante dhe çifutët.

Ekziston ndërlidhje e përgjithshme mes përkatësisë etnike dhe asaj fetare – shumica e besimtarëve ortodoksë janë maqedonas etnikë, kurse shumica e besimtarëve myslimanë janë shqiptarë etnikë.

Pjesa II. Gjendja e respektimit të lirive fetare nga Qeveria

Korniza ligjore/politike

Kushtetuta dhe Ligji i vitit 2007 për statusin ligjor të kishave, bashkësive dhe grupeve fetare e parasheh lirinë e besimit fetar. Ligjet dhe politikat tjera kanë kontribuar në praktikimin e lirë të besimit fetar, marrë në përgjithësi. Në të gjitha

nivelet, ligji e mbron plotësisht këtë të drejtë, pa dallim se a shkelet nga subjektet qeveritare ose ato private.

Ligji i vitit 2007 ka hyrë në fuqi në maj 2008, me çka është liberalizuar regjimi për regjistrimin e grupeve fetare, duke e lejuar regjistrimin e më tepër se një grupi për çdo konfesion fetar.

Nuk ekziston besim fetar zyrtar në nivel shtetëror, por në një amendament kushtetues të vitit 2001 ceken në mënyrë konkrete pesë grupe fetare: Kisha ortodokse maqedonase (KOM), Bashkësia islame e Maqedonisë, Kisha katolike romake, Bashkësia çifute dhe Kisha evangjelike metodiste. Para miratimit të ndryshimeve, Kushtetuta e ka cekur vetëm Kishën ortodokse maqedonase dhe "bashkësitë dhe grupet tjera fetare". Përkrahja shtetërore për ndërtimin e faltoreve e favorizon Kishën ortodokse maqedonase, e cila është dominante.

Qeveria i kremton Pashkët dhe Krishtlindjen ortodokse dhe Ramazan Bajramin (fundin e Ramazanit) si festa shtetërore. Festat tjera krishtere, islame dhe çifute nuk janë festa shtetërore, por janë caktuar nga qeveria si festa fetare për besimtarët e besimeve gjegjëse.

Ligji i bën thirrje grupeve fetare të regjistrohen, me qëllim të marrjes së statusit të subjektit juridik dhe parasheh që të gjitha grupet (e regjistruara) janë të ndara nga shteti dhe të barabarta para ligjit. Ligji parashtron listë-kontrolluese të detajuar të materialeve për aplikim për regjistruarit e ri, si dhe për procesin e bartjes së regjistrimit të grupeve që janë regjistruar sipas ligjeve paraprake, deri në fund të vitit 1998.

Të huajt të cilët vijnë në vend me qëllim të ushtrimit të punës fetare ose riteve fetare, duhet të marrin leje nga Komisioni shtetëror për marrëdhënie me besimet dhe grupet fetare, për të marrë vizë hyrëse. Gjatë aplikimit për vizë, këta persona duhet ta parashtrorjnë në Komision letrën me të cilën ftohen nga përfaqësuesit e organizatës fetare në vend. Komisioni pastaj e lëshon letrën me të cilën jepet aprovimi që duhet të parashtrorhet së bashku me kërkesën për vizë. Komisioni ka raportuar që procedura e shqyrtimit zgjatë më pak se një javë. Nuk ka pasur ankesa nga grupet fetare që kjo procedurë të ketë zgjatur më tepër.

Ligji nuk i lejon shkollat fillore private fetare, por nuk ka kufizime për shkollat private fetare në nivel të arsimit të mesëm dhe superior, si dhe për arsimin fetar që zhvillohet në hapësirat fetare, për shembull në kisha dhe xhami. Ministria e arsimit, gjatë vitit shkollor 2008-2009, nisi programin për arsim fetar për nxënësit e klasës

së gjashtë të shkollave fillore, ku prindërit e nxënësve duhej të zgjedhin mes lëndës doktrinare të një besimi fetar dhe lëndës sekulare mbi historinë e religjioneve. Më 15 prill 2009, Gjykata kushtetuese vendosi që lënda e një religjioni nuk është në pajtim me ndarjen kushtetuese të kishës dhe shtetit. Ministria e arsimit ka vepruar sipas vendimit dhe i ka ndërprerë orët mësimore të një besimi fetar. Vendimi i Gjykatës kushtetuese e ka lejuar vazhdimin e lëndës së historisë së besimeve fetare, deri në fund të vitit shkollor. Në fund të periudhës raportuese, Ministria e arsimit i ka shpallur planet për zhvillimin e lëndës "Etika e besimeve fetare" për vitin shkollor 2009-2010, duke kërkuar prej nxënësve dhe prindërve të zgjedhin mes historisë së besimeve fetare dhe etikës së religjioneve.

Kufizimet e lirive fetare

Qeveria, në përgjithësi, e ka respektuar lirinë fetare në praktikë. Megjithatë, dështimi për zbatimin efektiv të procedurave të reja të regjistrimit të grupeve fetare e ka penguar mundësinë e tyre për marrjen e statusit ligjor.

Në maj 2008, Gjyqi i Shkupit II mori përsipër përgjegjësinë e regjistrimit të grupeve fetare, në bazë të ligjit të vitit 2007. Njëherazi, ligj i përcakton orar të qartë gjyqit për përfundimin e procesit regjistruar – 15 ditë për të shqyrtuar nëse aplikacioni është i plotë dhe tetë ditë tjera për shënimin e grupit në regjistër. Ligji kërkon që emrat dhe shenjat zyrtare të grupeve të reja të dallohen nga emrat dhe shenjat e grupeve që janë regjistruar paraprakisht, por e lejon regjistrimin e më tepër grupeve të besimit të njëjtë fetar. Gjyqi Shkupi II e ka ngarkuar një gjykatës të vetëm me detyrën e regjistrimit, i cili nuk i është përmbajtur afateve kohore të kërkuara nga ligji, kështu që shumë aplikues presin muaj me radhë pa asnjë informatë. Disa aplikues kanë besuar se udhëzimet për aplikim kanë qenë konfuze, pasi që prej gjyqit kanë pranuar vendime me të cilat refuzohen aplikacionet, për shkaqe që nuk ceken qartë në listën e kërkesave të ligjit, përfshirë edhe kërkesën që "personi përgjegjës" i grupit të jetë shtetas i Maqedonisë, si dhe obligimin që kërkesa e grupit për inkuorporim të jetë me datë më të vonshme se hyrja e ligjit të ri në fuqi. Gjykatësi kompetent dhe kryetari i gjyqit kanë cekur që do të kërkojnë prej aplikuesve të rinj të sigurojnë burime të mësimdhënies dhe liturgjisë, të ndryshme nga ato të grupeve ekzistuese, që në dukje synon mbrojtjen e autonomisë së grupeve që tashmë janë regjistruar dhe është në kundërshtim me frymën e ligjit.

Gjatë periudhës raportuese, gjyqi ka miratuar dy aplikantë të rinj – Kishën Krishtere Fjala e Shpresës dhe Lëvizjen Reformatore Adventiste të Ditës së shtatë. Ndërsa ka refuzuar ose nuk kavepruar për aplikacionet e 11 bashkësive fetare –

Bashkësisë Bektashiane të Maqedonisë në Tetovë, Lajmërimit të kishës katolike, Oazës së kishës katolike, Lëvizjes krishtere Shpresa e Re, Kishës së të krishterëve të vërtetë ortodoks në Maqedoni, Kishës ungjillore baptiste, Bashkësisë bektashiane Ehlibejti të Maqedonisë, Kishës së lirë ungjillore Lajmi i mirë, Kryepeshkopatës Ortodokse Greke të Patrikanës së Pejës (emri i aplikimit të kishës së Jovan Vranishkovskit, e quajtur paraprakisht si Kryepeshkopatë ortodokse e Ohrit, meqë KOM-i ia ka shtuar emrit të vet fjalët " Kryepeshkopata ortodokse e Ohrit"), Grupit fetar kaderik Xhenet dhe Manastirit stavropegjik Sh. Xhon Hrysostom.

Disa kufizime të lidhura me statusin e grupit (si grup i paregjistruar) edhe më tej aplikohen ndaj "Kryepeshkopatës ortodokse të Ohrit", që e mohon autoqefalinë e vetëshpallur të Kishës ortodokse maqedonase (që nuk njihet as nga kishat tjera ortodokse). Grupi skizmatik i udhëhequr nga peshkopi i shkarkuar nga detyra në KOM, Jovan Vranishkovski, njihet nga Kisha ortodokse serbe si kryepeshkopatë. Anëtarët e grupit kanë pretenduar se ndaj tyre ka pasur vëzhgime dhe shqetësime të tepërta qeveritare, për shkak të besimit të tyre fetar. Anëtarët e kishës kanë raportuar se më 23 korrik të vitit 2008 dhe më 9-10 shkurt 2009 janë ndaluar në pikat kufitare, ku efektivet kufitarë i kanë urdhëruar t'i heqin veshjet e murgut për t'ua mundësuar kalimin e kufirit.

Përkrahja shtetërore për ndërtimin e faltoreve dhe objekteve tjera fetare e ka favorizuar bashkësinë dominante ortodokse. Pavarësisht nga protestat e organizatave joqeveritare (OJQ) dhe organizatave të studentëve, të cilët e kanë kundërshtuar ndërtimin për shkaqe të planifikimit hapësinor dhe të ndarjes së shtetit nga kisha, fillimi i ndërtimit të kishës ortodokse në sheshin kryesor të qytetit, i financuar nga qeveria, është paraparë të fillojë në qershor 2009, në bazë të dakordimit në një mbledhje të mbyllur qeveritare në qershor 2008. Mosmarrëveshja e ka arritur kulmin më 28 mars 2009, kur janë përplasur protestuesit në mbështetje dhe ata kundër ndërtimit të kishës. Por, planet për fillimin e punëve ndërtimore nuk janë prolonguar deri në momentin kur Ministria e kulturës ka dështuar në aprovimin e kontratës për ndërtimin, me shpjegimin që oferta e vetme i tejkalon shpenzimet e pritura. Më vonë, në qershor 2009, Qeveria ka shpallur që të drejtat e shfrytëzimit të tokës dhe dokumentacionit projektues do t'i barten KOM-it nga Ministria e kulturës. OJQ-të që kundërshtonin ndërtimin i shpallën planet për ta sfiduar transferin e pronës në gjyq. Nga ana tjetër, ndërtimi i Çarshi-xhamisë në Tetovë nuk ka filluar deri në fund të periudhës raportuese, edhe pse financimi për xhaminë është aprovuar në mbledhjen e Qeverisë një javë pas dakordimit për financimin e kishës ortodokse. Kërkesat e koalicionit të OJQ-ve për

lejimin e ndërtimit të Burmali-xhamisë në sheshin e qytetit të Shkupit nuk kanë marrë përgjigje deri në fund të periudhës raportuese.

Kishat dhe xhamitë shpesh herë ndërtohen pa sigurimin e lejeve ndërtimore. Por, Qeveria zakonisht nuk ndërmerr veprime ndaj grupeve fetare të cilat i shfrytëzojnë objektet ekzistuese për qëllime fetare. Prapëseprapë, deri në fund të periudhës raportuese, Gjyqi administrativ nuk ka vepruar sipas lëndës së parashtruar në vitin 2007 nga Dëshmitarët e Jehovës, lidhur me pronësinë dhe shfrytëzimin e sallës së mbledhjeve në një objekt në afërsi të Kriva Pallankës, qytet në veri-lindje të vendit.

Problemi i kthimit të pronës fetare, e cila ka qenë e shpronësuar nga qeveria e Ish-Jugosllavisë nuk është zgjidhur plotësisht. Disa bashkësi fetare nuk e kanë rikthyer pronësinë e plotë mbi shumë prona që janë shpronësuar nga regjimi komunist. Pronësia e pothuajse të gjitha kishave dhe shumë xhamive i është kthyer bashkësive fetare gjegjëse, por kjo nuk ka ndodhur me pjesën më të madhe të pronave tjera. Kërkesat për kthimin e pronës ose kompensim janë të komplikuar për shkak se prona e marrë e ka ndërruar pronarin disa herë ose ka qenë e eksploatuar. Bashkësia islame e Maqedonisë (BIM) ka cekur që nuk është në gjendje ta rikthejë të drejtën e shfrytëzimit të disa xhamive për të cilat Qeveria është dakorduar se do t'i kthejë dhe ka cekur që ndonëse janë dhënë premtime për shpronësim të plotë, është kthyer vetëm 7% e pronës. Përveç kësaj, BIM e ka akuzuar Qeverinë në disa raste për vonimin e shpronësimit, përmes shitjes ose fillimit të ndërtimit të ri në pronën kontestuese, si dhe për kontestimin e kërkesave ligjore historike të BIM-it për pronat fetare. BIM ka vazhduar të takohet me zyrtarët qeveritarë, me qëllim të gjetjes së zgjidhjes për çështjen e pronave.

Nuk ka pasur zhvillime lidhur me padinë e bektashinjve kundër Qeverisë të parashtruar në vitin 2002, për moskthimin e kompleksit të bektashinjve në Tetovë, të njohur si Arabati Baba Teqe, që është nacionalizuar në Ish-Jugosllavi. Më tej, nuk ka pasur zhvillime lidhur me padinë e vitit 2004, kur bektashitë e kanë paditur BIM-in për marrjen e një pjese të kompleksit të Tetovës nga pjesëtarë të armatosur të BIM-it në vitin 2002. BIM ka vazhduar me mbajtjen e kësaj pjese edhe në fund të periudhës që mbulohet nga ky raport. Tensionet mes bashkësisë bektashiane dhe BIM-it e kanë arritur kulmin në qershor 2009, gjatë varrimit të një anëtarit të bashkësisë së bektashive në tokën e kompleksit. BIM e ka quajtur varrimin si të paligjshëm dhe është kërcënuar me mënjanimin e trupit. Mosmarrëveshja ka mbetur e pazgjidhur deri në fund të periudhës raportuese.

Shkeljet e lirive fetare

Jovan Vranishkovski, udhëheqës i "Kryepeshkopatës ortodokse të Ohrit", i cili ka qenë i burgosur gjatë periudhave të plota ose të pjesërishtme të raporteve paraprake, ka qenë i lirë pas lirimit nga burgu në prill 2007. Megjithatë, zyrtarët qeveritarë edhe më tej refuzojnë t'ia kthejnë Vranishkovskit pasaportën e tij, kështu që ai ka mbetur jashtë vendit duke e shfrytëzuar pasaportën serbe gjatë tërë periudhës raportuese. Vranishkovski është ballafaquar me urdhër të paraburgimit për rigjykim të tretë për një rast të caktuar, për të cilin fillimisht është liruar nga Gjyqi themelor i Velesit në vitin 2006. Në këtë rast, Vranishkovski është ngarkuar për shpërdorim të mjeteve financiare të Kishës ortodokse maqedonase gjatë kohës kur ka qenë peshkop i KOM-it. Gjykatësi i Gjyqit në Veles ka kërkuar mendim prej një grupi ekspertësh për kontabilitetin e mbajtur nga Vranishkovski dhe avokati i tij ka raportuar që më 23 mars 2009, KOM është përpjekur të prezantojë dëshmi plotësuese para grupit të ekspertëve. Deri në fundin e periudhës raportuese, grupi i ekspertëve nuk ia ka dërguar mendimin avokatit të Vranishkovskit dhe nuk është caktuar rigjykim, meqë Vranishkovski nuk është paraburgosur.

Nuk ka pasur raporte për të burgosur ose paraburgosur për arsye fetare në vend.

Ndërrimi i dhunshëm i besimit fetar

Nuk janë paraqitur ndërrime të dhunshme të besimit fetar, përfshirë edhe shtetas të mitur të SHBA-ve, të rrëmbyer ose marrë ilegalisht nga Shtetet e Bashkuara ose të cilëve u është refuzuar kthimi në Shtetet e Bashkuara.

Përmirësimet dhe zhvillimet pozitive në drejtim të lirive fetare

Në janar 2009 ka përfunduar ndërtimi i shtëpisë memoriale të Nënës Terezë, në vendlindjen e saj në Shkup. Ndërtimi është financuar nga Ministria e kulturës. Përfaqësues të shumë bashkësive fetare i janë bashkëngjitur zyrtarëve qeveritarë dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare në ceremoninë e hapjes më 30 janar 2009.

Në fund të periudhës raportuese, Bashkësia çifute në Maqedoni dhe Fondi i saj për qendrën memoriale të Holokaustit i janë afruar përfundimit të Qendrës memoriale dhe artistike të Holokaustit në Shkup. Financimi është në vlerë prej 26.3 milionë

USD (€17 milionë), në bazë të marrëveshjes së vitit 2007 me Qeverinë për rikthimin e pronave çifute pa trashëgues.

Pjesa III. Gjendja e respektimit shoqëror të lirive fetare

Ka pasur disa raporte për keqpërdorim social ose diskriminim për shkak të përkatësisë, besimit fetar ose praktikimit të fesë.

Pjesa IV. Politika e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara

Ambasadori dhe përfaqësuesit e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara janë takuar vazhdimisht me zyrtarët e qeverisë, udhëheqësit dhe përfaqësuesit e bashkësive të ndryshme fetare, për t'i trajtuar çështjet e lirive fetare dhe për ta përkrahur tolerancën etnike dhe fetare.

Zyrtarët e Ambasadës e kanë diskutuar zbatimin e ligjit të vitit 2007 për statusin ligjor me gjyqin kompetent për regjistrim, si dhe me udhëheqësit qeveritarë dhe fetarë në disa raste, duke e mbështetur zbatimin e ligjit në mënyrë që i përmbushë standardet ndërkombëtare, në aspekt të të drejtave të njeriut dhe lirive fetare, me respektim të afateve të cekura në ligj. Nëpunësit e ambasadës gjithashtu kanë punuar ngushtë me disa grupe dhe bashkësi fetare që kërkojnë të regjistrohen, duke shërbyer si pikë qendrore për këmbimin e informatave mes aplikuesve, të cilët janë të frustruar nga vonesat gjyqësore dhe të hutuar nga mungesa e procedurave të qarta të aplikimit.

Në mars 2009, Ambasada e ka sponsoruar Programin e lidërshiptit për vizitorë ndërkombëtarë mbi jetën fetare dhe sferën publike, ku janë përfshirë përfaqësues nga bashkësi të ndryshme fetare dhe të OJQ-ve, të cilët i kanë vizituar Shtetet e Bashkuara për ta hulumtuar ndërveprimin mes fesë dhe shtetit, si dhe rolin e organizatave fetare në programet e mirëqenies sociale, përmes takimeve me zyrtarët qeveritarë, OJQ-të dhe organizata fetare.

Në shkurt 2009, nëpunësit e ambasadës dhe pjesëmarrësit e mëparshëm të programeve të këmbimit mbi fenë dhe bashkësinë kanë realizuar një prezantim në Këndin amerikan në Tetovë, në temën "Jeta myslimane në SHBA" duke u fokusuar në çështje të ndryshme të bashkësisë dhe lirive fetare. Ambasada ka organizuar edhe një iftar, duke i afruar grupet e ndryshme fetare, bashkësitë si dhe udhëheqësit politikë për nder të Ramazanit, si dhe për t'i diskutuar sfidat dhe sukseset e lirive fetare në vend. Përfaqësuesit e Ambasadës kanë komunikuar me audiencën televizive dhe të shtypit përmes intervistave, duke diskutuar çështje të lirisë fetare,

me përqendrim në përpjekjet e Kryetarit Obama drejt bashkësisë islamike në mbarë botën.

Ambasadori dhe përfaqësuesit tjerë të Ambasadës kanë qenë të pranishëm në ngjarjet për mbështetjen e lirisë, tolerancës dhe mirëkuptimit fetar, përfshirë edhe ngjarjet e komemoracionit të Holokaustit dhe shënimin e festave të grupeve të ndryshme fetare.